STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 26 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) ZHVILLON NJE TAKIM ME DELEGACIONIN E KONGRESIT TE NJU JORKUT, KRYETARIN E BASHKISE BLUMBERG DHE ZYRTARE TE QARQEVE RAJONALE PER TE ANALIZUAR VLERESIMIN E DEMIT PER SHTETIN PAS URGANIT SENDI (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) sot zhvilloi një takim me delegacionin e Kongresit te Shtetit të Nju Jorkut, Kryetarin e Bashkisë të Qytetit të Nju Jorkut Majkëll R. Blumbërg dhe Zyrtarë të Qarqeve Naso (Nassau), Safolk (Suffolk) dhe Uestçester (Westchester) për të analizuar një vlerësim të hollësishëm të dëmit dhe kostove të lehtësimit/parandalimit të ardhshëm si rezultat i Uraganit Sendi (Sandy), si dhe për të diskutuar mbi qëndrimin e shtetit në kërkimin e ndihmës federale shtesë për të ndihmuar në mbulimin e kostove të riparimit dhe rimëkëmbjes.

Kostoja e stuhisë, siç vlerësohet në këshillim me firma private përfshirë PricewaterhouseCoopers dhe PFM Group, si dhe qytetin dhe qarqet, përfshin:

- 32.8 miliardë dollarë në kosto të riparimit dhe rimëkëmbjes
- 9.1 miliardë në kosto të lehtësimit dhe parandalimit

"Shkatërrimi i shkaktuar nga Uragani Sendi (Sandy) është i proporcioneve të papara, duke u renditur mes katastrofave natyrore më të këqija në historinë e kombit tonë përsa i përket humbjes së jetës, dëmit të pasurisë dhe ndikimit ekonomik," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Takimi i sotëm me delegacionin e Kongresit të shtetit tonë mbështetet mbi bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet partnerëve vendore, shtetërore dhe federalë që ka ekzistuar përgjatë Uraganit Sendi (Sandy) dhe pas stuhisë. Duke punuar së bashku, do të rindërtohemi më të fortë dhe më mirë sesa ndonjëherë më parë, në mënyrë që Shteti i Nju Jorkut të jetë i përgatitur më mirë dhe të ketë infrastrukturën për t'u bërë ballë incidenteve të mëdha të ardhshme të motit."

Në qendër të takimit të delegacionit sot ishin 32.8 miliardë dollarët në kosto të riparimit dhe reagimit dhe nevoja për 9.1 miliardë dollarë në shpenzime të lehtësimit/parandalimit që ndahet në kategoritë e mëposhtme:

Kostot e rimëkëmbjes dhe parandalimit (në miliona dollarë)	
Qyteti i Nju Jorkut	15,045.10
Qarku Naso (Nassau)	6,602.60
Qarku Safolk (Suffolk)	1,784.90
Qarku Uestçester (Westchester)	527.80
Qarku Roklënd (Rockland)	143.70
Qarqe të tjera	18.10
Ndërmarrjet e shërbimeve	1,504.00
Agjencitë dhe autoritetet e tranzitit të Shtetit të Nju Jorkut	7,177.90
Gjithsej për rimëkëmbje	**32,804.10**
Gjithsej për parandalim dhe lehtësim	**9,080.80**
GJITHSEJ PER RIMEKEMBJE DHE PARANDALIM	**41,884.90**

Kostot e rimëkëmbjes (në miliona dollarë)	
Reagimi qeveritar	1,627.30
Ndihma individuale	913.30
Strehimi	9,672.00
Ndikimi mbi bizneset	6,000.00
Shëndeti	3,081.00
Shkollat	342.70
Tranziti, rrugët dhe urat	7,348.10

Parqet dhe mjedisi	793.90
Uji, mbeturinat dhe ujrat e zeza	1, 060.3
Ndërmarrjet e shërbimeve	1,504.00
Të ardhurat nga funksionimi i qeverisë	461.50
GJITHSEJ	**32,804.10**

Në krahasim me Katrinën		
	Sendi (Sandy) në Nju Jork	**Katrina & Rita në Luiziana**
Njësitë e strehimit të dëmtuara ose të shkatërruara	305,000*	214,700
Mungesat e energjisë (piku)	2,190,000	800,000
Bizneset e prekura	265,300	18,700
*Ky numër përfshin vetëm vlerësimin deri tani; numri pritet të rritet		

Një ndarje e mëtejshme e kostove është përfshirë në tabelën e bashkëngjitur.

Delegacioni dhe Guvernatori diskutuan mbi kërkimin e ndihmës federale shtesë për të përmbushur kostot e riparimit dhe të rimëkëmbjes.

9 miliardë dollarët në kostot e lehtësimit/parandalimit përfshijnë veprime “logjike “ të lehtësimit, si mbrojtja nga përmbytja e vendit të Qendrës Botërore Tregtare (World Trade Center) dhe rrugëve e tuneleve të prekshëm të metrosë, sistemin e furnizimit me karburant, krijimin e energjisë, mbrojtjen nga përmbytja të uzinës së trajtimit të ujrave të zeza dhe sisteme dytësore të furnzimit me energji për mjediset e kujdesit shëndetësor.

Vlerësimet e dëmit janë krijuar në këshillim me PriceWaterhouseCoopers dhe PFM Group. Analiza e PFM-së vë në dukje se vlerësimet janë përgjithësisht konservative dhe disa fusha, përfshirë strehimin, mund të nënvlerësojnë shkallën e ndikimit.

Senatori i SHBA-së Çarls Shumer (Charles Schumer) tha, “Nju Jorku ka pësuar një dëm të paparë nga Uragani Sendi (Sandy), si të gjerë, ashtu edhe të thellë dhe kërkon një reagim të fortë dhe po aq të rëndësishëm nga Qeveria Federale. Guvernatori, pasi diskutoi me Kryetarin e Bashkisë Blumbërg dhe zyrtarë të qarqeve, na ka dhënë një vlerësim të hollësishëm dhe të rëndësishëm të dëmit të katastrofës që dokumenton gjerësisht dëmin e rëndë që ka pësuar Nju Jorku dhe banorët e Nju Jorkut. Duke punuar me Administratën dhe delegacionin, si dhe me kolegë nga shtetet e tjera të prekura, do të bëjmë gjithshka që mundemi për të shtuar ndihmën që merr Nju Jorku. Mos bëni gabim, kjo nuk do të jetë një detyrë e lehtë, veçanërisht duke ditur shkëmbin fiskal të ardhshëm dhe një Kongres që ka qënë shumë më pak miqësor ndaj ndihmës për katastrofat sesa në të kaluarën. Kjo do të jetë një përpjekje që zgjat jo disa javë, por disa muaj dhe nuk do të pushojmë derisa reagimi federal të përmbushë nevojat e thella dhe të gjerë të Nju Jorkut.”

Senatorja e SHBA-së Kirstën Xhillibrend (Kirsten Gillibrand) tha, “Imazhet e shkatërrimit që pësoi Nju Jorku nga Uragani Sendi (Sandy) tregojnë vetëm gjysmën e historisë së kësaj katastrofe të paparë. Kam kaluar ditë pas dite në takime me familje të Nju Jorkut jeta e të cilave është copëtuar, shtëpitë e tyre janë shkatërruar dhe bizneset janë në rrënoja. Banorët e Nju Jorkut janë të vendosur, ne përkulemi, por nuk thyhemi, por nuk mund t’a bëjmë këtë vetëm. Qeveria federale ka një përgjegjësi të qartë për të përkushtuar të gjitha burimet e nevojshme për të na ndihmuar që të rindërtojmë. Kjo nuk do të jetë një luftë e lehtë, por jemi të bashkuar si një delegacion dhe me Guvernatorin Kuomo (Cuomo) dhe Kryetarin e Bashkisë Blumbërg ne të gjithë do të luftojmë mjaft për t’ia arritur qëllimit për çdo dollar që ka nevojë Nju Jorku.”

Përfaqësuesi i SHBA-së Çarls Rengël (Charles Rangel) tha, “Guvernatori ka bërë një punë të shkëlqyer në përshkrimin e nevojave të Nju Jorkut si rezultat i Uraganit Sendi (Sandy). Detyra jonë tani është të bëjmë që kjo ndihmë t’i sigurohet Shtetit sa më shpejt që të jetë e mundur. Me kaq pak kohë të mbetur në këtë sezon të Kongresit nuk do të jetë e lehtë. Por jemi duke folur për jetesën e milionave që kanë nevojë që ne t’a bëjmë këtë gjatë këtij viti dhe do të luftojmë që ajo të ndodhë.”

Përfaqësuesi i SHBA-së Edolfus Tauns (Edolphus Towns) tha, “Si shumë vende të tjera anembanë Shtetit të Nju Jorkut, pjesë të Bruklinit (Brooklyn) u goditën rëndë nga Uragani Sendi (Sandy). Përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) dhe zyrtarët e shtetit për reagimin e tyre në kohë dhe të plotë për vlerësimin e dëmit dhe për të ndihmuar banorët e Nju Jorkut. Kam besim se do të luftojnë për çdo dollar në Uashington për të siguruar një rimëkëmbje të plotë.”

Përfaqësuesja e SHBA-së Nita Loui (Nita Lowey) tha, “Dëmi që Sendi (Sandy) shkaktoi në Qytetin e Nju Jorkut dhe në Luginën e poshtme të Hadsonit (Hudson) ishte i rëndë dhe shumë punë mbetet për të ndihmuar banorët, pronarët e bizneseve dhe pushtetin vendor për t’u rimëkëmbur dhe për t’u rindërtuar. Do të punoj me Guvernatorin Kuomo (Cuomo), delegacionin e Nju Jorkut, zyrtarë vendorë dhe kolegë në të dyja anët për t’u siguruar se qeveria federale bën punën e saj për të siguruar ndihmën që ka nevojë rajoni ynë.”

Përfaqësuesi i SHBA-së Xherrold Nedlër (Jerrold Nadler) tha, “Shkatërrimi në Nju Jork pas Uraganit Sendi (Sandy) mund të shihet ende kudo anembanë qytetit dhe është veçanërisht e dhimbshme për votuesit e mij në Koni Ajlënd (Coney Island), Sigejt (Sea Gate), Red Huk (Red Hook) dhe Manhatanin e Poshtëm (Lower Manhattan). Mijëra njerëz janë ende të zhvendosur, mijëra njerëz janë duke u përpjekur të rindërtojnë dhe mijëra njerëz janë duke u përpjekur të kthehen në jetën normale. Do t’a çojmë vlerësimin e përgjithshëm të dëmit nga Guvernatori Kuomo (Cuomo) në Kongres dhe do të punojmë për t’u siguruar se Nju Jorku merr çdo dollar që ka nevojë për t’u rindërtuar dhe për të shkuar përpara.”

Përfaqësuesi i SHBA-së Pitër King (Peter King) tha, “Duke ditur dëmin katastrofik të shkaktuar në Nju Jork, jam i përkushtuar për të punuar me Guvernatorin Kuomo (Cuomo) dhe delegacionin e Kongresit për t’u siguruar se Long Ajlënd (Long Island) dhe Nju Jorku marrin ndihmën federale që u duhet për t’u rimëkëmbur.”

Përfaqësuesja e SHBA-së Kerëlin Malloni (Carolyn Maloney) tha, “Supër stuhia bëri dëm të madh në Nju Jork dhe do të duhen përpjekje të qëndrueshme--dhe financim të qëndrueshëm--që gjërat të kthehen përsëri në normalitet. E di se do të bashkohem me kolegët e mi në delegacion për të luftuar për çdo dollar të rimëkëmbjes që kemi nevojë.”

Përfaqësuesja e SHBA-së Nidia Velazkez (Nydia Velazquez), “Guvernatori na dha një azhornim të plotë sesi Shteti është duke punuar për t’u dhënë ndihmë atyre që u prekën nga Uragani Sendi (Sandy). Duhet të vazhdojmë të bashkërendojmë në të gjitha nivelet e qeverisë – federale, shtetërore dhe vendore – për të rindërtuar dhe riparuar komunitetet tona.”

Përfaqësuesi i SHBA-së Gregëri Miks (Gregory Meeks) tha, “Uragani Sendi (Sandy) shkaktoi dëm katastrofik në Qytetin e Nju Jorkut dhe në Long Ajlënd (Long Island). Përfshirja e drejtpërdrejtë e Guvernatorit – përfshirë në rrethin tim – ka qënë vendimtare. E njëjta gjë mund të thuhet për aspektin e plotë të vlerësimit të shkatërrimit nga administrata e tij. Ajo që kanë përjetuar banorët e Nju Jorkut është një tragjedi amerikane. Lagjet, bizneset, pronat, infrastruktura dhe ekonomia jonë e intergruar me botën nuk mund të rimëkëmbet ose të rindërtohet pa ndihmë dhe pa burime federale. Secili prej nesh është i vendosur që të punojë pa lodhje me Presidentin Obama dhe kolegët tanë në Kongres për t’u siguruar se Nju Jorku merr ndihmën federale që ka nevojë. Nëse kishte ndonjëherë nevojë për t’u bashkuar, kjo është ajo.”

Përfaqësuesi i SHBA-së Xho Kroulli (Joe Crowley) tha, “Sendi (Sandy) na la me një sasi dëmi dhe shkatërrimi të paparë anembanë Qytetit të Nju Jorkut dhe të gjithë shtetit. Familjet, bizneset dhe komunitete të tëra tani përballen me sfidën e frikshme të rindërtimit të jetës së tyre. Nuk ka dy mënyra për të: nuk mund të rindërtojmë pa ndihmë nga qeveria federale. Falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për udhëheqjen e tij gjatë gjithë stuhisë dhe mezi pres që të punoj me të, si dhe me kolegët e mi, për t’u siguruar se Nju Jorku merr çdo dollar që i nevojitet për t’u rimëkëmbur e për t’u rindërtuar.”

Përfaqësuesi i SHBA-së Majkëll Grim (Michael Grimm) tha, “Stejtën Ajlënd (Staten Island) është shkatërruar nga Uragani Sendi (Sandy) dhe disa javë më pas vetëm jemi duke filluar të shohim sferën e

dëmit, i cili padyshim do të rritet në kosto me kalimin e kohës. Në takimin e sotëm me Guvernatorin Kuomo (Cuomo), një gjë mbetet e qartë: Republikan ose Demokrat, pikë së pari jemi banorë të Nju Jorkut. Qëndrojmë të bashkuar si një delegacion në bërjen e gjithshkaje që duhet për të siguruar ndihmën e nevojshme për të rindërtuar komunitetet tona dhe për t'a çuar Nju Jorkut drejt një rimëkëmbje të plotë dhe të shpejtë."

Përfaqësuesi i SHBA-së Bob Turner tha, "Përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për prezantimin e tij të hollësishëm duke paraqitur një plan të efektshëm të bashkuar për të ndihmuar banorët e Nju Jorkut të prekur nga Sendi (Sandy). Nuk jemi Republikanë ose Demokratë, jemi të gjithë banorë të Nju Jorkut duke punuar për të rindërtuar Shtetin që e duam dhe mezi pres të vazhdoj diskutimin në lidhje me burimet që do të jenë të nevojshme për të rindërtuar dhe mbështetur të ardhmen tone."

Kryetari i Bashkisë i Qytetit të Nju Jorkut Majkëll R. Blumbërg (Michael R. Bloomberg) tha, "Uragani Sendi (Sandy) shkaktoi dëm të gjerë në strukturën tonë dhe zhvendosi mijëra njerëz. Duke punuar nga afër me partnerët tanë të Shtetit dhe ata Federalë kam besim se mund të rindërtojmë dhe të rimëkëmbim Qytetin tonë të shkëlqyer."

Zyrtari i Qarkut Naso (Nassau) Eduard P. Mangano (Edward P. Mangano) tha, "Përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo), Senatorët e SHBA-së Shumer dhe Xhilibrend dhe të gjithë anëtarët tanë të Kongresit që janë bashkuar për të kuptuar nevojat vendore dhe për të këshilluar për ndihmë të menjëhershme për banorët tanë që janë duke u përpjekur të rimëkëmben nga Uragani Sendi (Sandy). Ky takim mbështetet në vizitën e Presidentit Obama ku ai na siguroi se qeveria federale do të ndihmojë në përpjekjet monumentale të rindërtmit."

Zyrtari i Qarkut Safolk (Suffolk) Stiv Bellone (Steve Bellone) tha, "Kemi patur një takim mjaft të dobishëm sot me Guvernatorin dhe Delegacionin Federal të Nju Jorkut. Nevojat e Qarkut Safolk (Suffolk) janë pasqyruar saktë si pjesë e procesit dhe mezi pres që të punoj me Delegacionin Federal ndërsa riparojmë dhe rindërtojmë në Qarkun Safolk (Suffolk)."

Zyrtari i Qarkut Uestçester (Westchester) Robert P. Astorino tha, "Eshtë e rëndësishme se të gjithë kemi të njëjtin qëndrim si banorët e Nju Jorkut dhe jo si Republikanë ose Demokratë. Kemi nevojë të flasim me një zë ndërsa kërkojmë rimbursimin e kostos së rimëkëmbjes nga qeveria federale për këtë stuhi të tmerrshme. Dhe takimi i sotëm ishte një hap i mirë përpara në atë proces."

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

(Shihni skedarin e bashkëngjitur: Përmbledhje e ndikimit të Sendit (Sandy).pdf)

Albanian